



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

për vizitën në Qendrën e Azilit në Magure, Lipjan

Drejtuar: Z. Xhelal Sveçla, ministër në detyrë
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Valon Krasniqi, drejtor
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim

Z. Fitim Zariqi, drejtor
Qendra për Azil

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, 27 tetor 2025

Hyrje

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm: MKP) më 4 shtator 2025 vizitoi Qendrën për Azil në Magurë, Lipjan.

Qëllimi i vizitës

1. Qëllimi i vizitës në qendrën e lartpërmendur për akomodimin e azilkërkuesve ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të aplikuesve nga autoritetet e Republikës së Kosovës, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Përbërja e grupit monitorues të MKP-së

2. Grupi monitorues përbëhej nga dy këshilltarë juridikë për parandalimin e torturës, një psikologe dhe një punëtore sociale.

Bashkëpunimi me MKP-në gjatë realizimit të vizitave

3. Gjatë vizitës, personeli i Qendrës së Azilit i ofroi MKP-së bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për realizimin e detyrës dhe iu mundësua qasja në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe intervistimi i azilkërkuesve pa praninë e personelit të Qendrës së Azilit.

Qendrën e Azilit

4. Qendra për Azil menaxhohet nga Ministria e Punëve në Brendshme (në vijim: MPB) në bazë të Rregullores (MPB) nr. 03/2018 për Funksionimin e Qendrës për Azil (tani e tutje: Rregullorja). Sipas nenit 4, pika 1.3, të Rregullores dhe të Ligjit për Azil, Qendra për Azil definohet si në vijim: *“Çdo vend që përdoret për pranimin dhe akomodimin kolektiv të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.”* Ndërsa sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje, Qendra organizohet dhe funksionon si institucion qendror, në kuadër të MPB-së dhe Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (tani e tutje: DShAM), me seli në Magurë të Lipjanit.
5. Kapaciteti zyrtar i Qendrës së Azilit është 100 persona, ndërsa në momentin e vizitës në këtë qendër ishin të vendosur 24 aplikues, prej të cilëve dy ishin familje me fëmijë. Azilkërkuesit ishin kryesisht nga Palestina, Jordania, Maroku, Afrika e Jugut dhe vende të tjera. Sipas drejtorit të Qendrës, qëndrimi mesatar i aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare në qendër është rreth 30 ditë.

Procedurat e pranimi

6. Neni 14 i Rregullores përcakton se DShAM-ja, në kuadër të MPB-së, në bazë të dokumenteve përkatëse, vendos nëse një individ duhet të strehohet në Qendër ose në ndonjë vend tjetër. Qendra konfirmon strehimin e aplikuesit me anë të fletëpranimit, i cili i bashkëngjitet dosjes së aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare.
7. Sipas drejtorit të Qendrës së Azilit, funksionalizimi i Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë në Vranidoll lehtëson ndjeshëm punën e Qendrës së Azilit, pasi migrantët

fillimisht akomodohen atje dhe më pas, nëse kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, vendosen në Qendrën e Azilit.

8. Po ashtu, drejtori pohoi se, pas akomodimit, Qendra e Azilit u lëshon aplikuesve dokumentet si në vijim:

- Certifikata e statusit të aplikuesve - lëshohet brenda tri ditësh.
- Letërnjoftimi për aplikues - lëshohet brenda shtatë ditësh.

(Dokumentet e lartpërmendura i lëshohen aplikuesit për aq kohë sa zgjat procedura e përcaktimit të statusit të mbrojtjes. Letërnjoftimi i aplikuesit po ashtu shërben si leje për qëndrim në Republikën e Kosovës deri në shqyrtimin e aplikacionit për mbrojtje ndërkombëtare, në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Azil).¹

- Fletudhëtim për aplikues - lëshohet për arsye serioze humanitare kur kërkohet prania e tyre në një shtet tjetër.

Të drejtat e aplikuesve sipas Ligjit nr. 06/L-026 për Azil dhe sipas Rregullores

9. Neni 26 i Ligjit nr. 06/L-026 për Azil përcakton të drejtat e aplikuesve, të cilët do të qëndrojnë në Kosovë, e të cilat janë: të ketë kushtet themelore të jetesës; kujdesin shëndetësor; ndihmën sociale themelore; ndihmën ligjore pa pagesë; të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit fëmijë; të drejtën për lirinë e mendimit dhe të besimit fetar; të drejtën për punësim; të drejtën për trajnime profesionale.

10. Ndërsa neni 5, paragrafi 2, i Rregullores shprehimisht përcakton: *“Asnjë aplikues nuk do t’i nënshtrohet torturës, trajtimit jonjerëzor ose përvulës.”* Më tej, në nenin 5, paragrafi 1, të Rregullores shprehimisht theksohet: *“Zyrtarit të qendrës duke përfshirë të gjithë ata që punojnë në qendër, iu ndalohet të diskriminojnë ose të fyejnë dinjitetin e aplikuesit, për shkak të racës, besimit fetar, gjinisë, kombësisë, përkatësisë në një grup shoqëror ose bindjeve politike.”* MKP-ja konsideron se dispozitat në fjalë përbëjnë garanci të duhura procedurale kundër keqtrajtimit, trajtimit poshtërues dhe çnjerëzor, si dhe kundër trajtimit diskriminues.

Njoftimi për të drejtat e tyre themelore

11. Neni 11 i Rregullores përcakton se DShAM-ja përgatit një broshurë, në disa gjuhë të huaja, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e aplikuesve gjatë procedurës së azilit dhe qëndrimit në Qendër. Kjo broshurë vihet në dispozicion të aplikuesve nga Qendra e Azilit.

12. MKP-ja vërejtë se aplikuesit informohen për të drejtat e tyre dhe për procedurat e azilit përmes broshurave dhe dokumenteve të shkruara në gjuhën arabe, angleze, frënge, turke dhe serbe. Përveç kësaj, në korridoret e Qendrës së Azilkërkuesve në Magurë janë instaluar ekrane të mëdha, përmes të cilave aplikuesit informohen për të drejtat e tyre në gjuhën shqipe, anglisht dhe arabisht. Po ashtu, në dispozicion të aplikuesve dhe zyrtarëve të MPB-së është edhe përkthyesja për gjuhën shqipe dhe atë arabe, e angazhuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM).

¹ Ligji Nr. 06/L- 026 për Azil, neni 18 - Qëndrimi, liria e lëvizjes dhe mbajtja: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=100032>

13. MKP-ja gjatë vizitës intervistoi disa aplikues të pranishëm në Qendër dhe nuk morën ankesa për sa i përket njoftimit për të drejtat e tyre.

Trajtimi

14. Gjatë vizitës, MKP-ja realizoi intervista grupore dhe individuale me aplikuesit. Intervistat u realizuan në gjuhën angleze. MKP-ja nuk mori ankesa për sa i përket keqtrajtimit. Përveç kësaj, MKP-ja vërejti komunikim shumë miqësor ndërmjet aplikuesve dhe personelit të Qendrës së Azilit.
15. Përveç kësaj, MKP-ja vizitoi dhe intervistoi aplikuesin, i cili shprehu shqetësime tek OJQ “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut” (YIHR), duke pohuar se nuk po trajtohet si duhet. Gjatë intervistës, i njëjti pohoi se nuk u keqtrajtua ndonjëherë, por theksoi se dhoma nuk pastrohet nga stafi, nuk ka rroba në masën e tij dhe ushqimi nuk është në sasi të mjaftueshme. Këto shqetësime u adresuan menjëherë te drejtori i Qendrës, i cili pohoi se dhoma duhet të pastrohet nga vetë aplikuesit, pasi ata kanë në dispozicion të gjitha mjetet higjienike. Për sa i përket rrobave, aplikuesit vetë i zgjedhin ato, por stafi do të kujdeset që të gjendet masa e duhur. Lidhur me sasinë e ushqimit, drejtori pohoi se shujta ofrohet njësoj për të gjithë aplikuesit, mirëpo do të shqyrtohet mundësia e shtimit të ushqimit për këtë aplikues.

Kushtet e akomodimit

16. Gjatë vizitës në Qendrën e Azilit në Magurë, MKP-ja vërejti se kushtet e akomodimit janë në përgjithësi të një standardi që aplikohet në raste të tilla për sa u përket hapësirës për banim, ndriçimit, pastërtisë dhe ngrohjes.
17. Ekipi vërejti se, edhe pse Qendra u rinovua dhe i plotëson standardet për hapësirën, ndriçimin, pastërtinë dhe ngrohjen, tri dhoma janë jashtë funksionit për shkak të lagështisë dhe rrjedhjes së ujit nga kulmi. Ky informacion u bë i ditur për ekipin e MKP-së qysh në fillim të takimit edhe nga drejtori i Qendrës.

Të drejtat fetare

18. Ekipi i MKP-së, bazuar në intervistat e realizuara, nuk mori asnjë ankesë nga aplikuesit lidhur me të drejtën për ushtrimin e riteve fetare në Qendër, e cila është e garantuar me nenin 40 të Rregullores mbi Funkcionimin e Qendrës së Azilit.

E drejta për ndihmë themelore sociale

19. E drejta për ndihmë themelore sociale u garantohet aplikuesve me Ligjin për Azil.² Lidhur me shfrytëzimin e kësaj të drejte, MKP-ja nuk mori asnjë ankesë nga aplikuesit. Përveç kësaj, MKP-ja u njoftua nga drejtori i Qendrës se stafi i saj aplikon për secilin aplikues për shfrytëzimin e kësaj të drejte. Ndihma sociale për aplikuesit është e njëjtë me atë që ofrohet për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ushqimi

20. Ligji për Azil dhe Rregullorja përcaktojnë të drejtën e aplikuesit për ushqim. MKP-ja u njoftua se aplikuesve në Qendër u ofrohen tri shujta me ushqim gjatë ditës. Aplikuesve u shërbehet ushqimi nga kompania kontraktuese Global Parajsa, me tri shujta në ditë.

² Ligji nr. 06/L-026 për Azil, neni 26, pika 1.4.

Kujdesi shëndetësor

21. MKP-ja vërejtë se shërbimet mjekësore për të huajt në këtë Qendër u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare më e afërt dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Përveç kësaj, MKP-ja vërejtë se një mjek u angazhua nga Jezuit Refugee Service (JRS), i cili Qendrën e Azilit e furnizon me barna dhe me materiale të tjera. MKP-ja nuk mori ankesa nga azilkërkuesit për sa u përket shërbimeve mjekësore. Përkundrazi, azilkërkuesit pohuan se shërbimet e nevojshme u jepën në afat sa më të shpejtë.
22. Shërbimet psikologjike ofrohen nga organizata Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT).

Fëmijët

23. Gjatë vizitës në Qendrën e Azilit, aty ishin të akomoduara dy familje me fëmijë. Gjatë vizitës, MKP-ja u njoftua se tani për tani në Qendër nuk ka fëmijë të pashoqëruar, e as viktima të identifikuar të dhunës dhe të torturës.
24. Neni 31 i Rregullores përcakton se interesi më i mirë i fëmijëve duhet të merret në konsideratë gjatë zbatimit të Rregullores. Sipas Rregullores, fëmijëve që kanë qenë viktimë e çfarëdo forme të abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe johuman, ose që kanë vuajtur nga konfliktet e armatosura, do t'u ofrohen shërbime adekuate të trajtimit shëndetësor dhe këshillime të kualifikuara, kur është e nevojshme. Po ashtu, sipas Rregullores, fëmijëve të akomoduar në Qendër do t'u sigurohet qasje në aktivitete zbavitëse dhe në lojëra, në përputhje me moshën e tyre.
25. MKP-ja vëren se brenda Qendrës dhe në oborrin e saj ekziston këndi i lojërave për fëmijë, ndërsa fëmijët që i plotësojnë kriteret vijnë në mësimin fillor në shkollën fillore afër Qendrës.
26. Ekipi i MKP-së intervistoi një familje, e cila nuk pati ankesa lidhur me trajtimin dhe kushtet në Qendër. Mirëpo shprehu shqetësime se ambienti nuk është i përshtatshëm për familjet, pasi ato janë të vendosura në katin e dytë të Qendrës, ndërsa në katin e parë janë meshkujt beqarë. Për shkak të afërsisë së kateve dhe hyrjes së njëjtë, familja pohoi se nuk ka shumë liri, fëmijët dhe nënat shumicën e kohës e kalojnë në dhomë, edhe pse nuk u evidentua ndonjë shqetësim nga banorët e tjerë.

Aktivitetet sociale dhe të edukimit

27. MKP-ja vizitoi të gjitha hapësirat dhe vërejtë se Qendra ka dhomat e aktiviteteve për të rritur, të cilat janë të pajisura me TV, me wi-fi gjatë gjithë kohës, letra, shah si dhe në një kënd është biblioteka me një numër të vogël librash. Dhoma e aktiviteteve për fëmijë është e pajisur me lodra dhe e dizajnuar sipas standardeve.
28. Gjithashtu, oborri i Qendrës ka fushën e futbollit dhe hapësirë të mjaftueshme për aktivitete sportive. Në këtë Qendër organizohen kurse të gjuhës shqipe dhe të rrobaqepësisë.

Kontaktet me botën e jashtme

29. Sipas Rregullores, aplikuesve u lejohet të pranojnë vizita në Qendër, të marrin pako dhe korrespondencë, të përdorin telefonin e Qendrës për të komunikuar sipas orarit të caktuar,

si dhe të dalin nga Qendra nga ora 7:00 deri në ora 22:00.³ Po ashtu, Rregullorja përcakton se Komisionari i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe organizatat e ndryshme joqeveritare kanë qasje në Qendër. Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë qasje dhe komunikim të pakufizuar me aplikuesit në Qendër.⁴

Masat disiplinore dhe incidentet

30. Neni 51 i Rregullores përcakton masat disiplinore që mund t'u shqiptohen aplikuesve të vendosur në Qendër, nëse nuk zbatojnë udhëzimet e përcaktuara në këtë Rregullore, të cilat janë: refuzimi i lejes për dalje nga objekti; kufizimi i qasjes në TV apo në internet.
31. Në rast se ndonjëri nga aplikuesit e vendosur në Qendër manifeston dhunë apo sjellje agresive, me ç' rast rrezikon rendin dhe sigurinë në Qendër, i njëjti mund të vendoset në dhomat e veçanta të Qendrës dhe menjëherë rasti paraqitet tek organet kompetente (njoftohet Policia).
32. Sipas drejtorit, deri më tani nuk u përdor masa disiplinore e vendosjes në dhoma të veçanta. Përgjegjëse për sigurinë në Qendër është kompania kontraktuese, e cila ofron sigurim fizik për objektet dhe ishte e pranishme edhe gjatë vizitës së MKP-së.
33. Lidhur me incidentet e ndodhura ndërmjet aplikuesve, MKP-ja u njoftua nga drejtori i Qendrës së Azilit se, në rastet kur ndodhin incidente midis aplikuesve të vendosur në Qendër, intervenon sigurimi fizik dhe njoftohet menjëherë Policia e Kosovës. Drejtoria nuk ndërmerr asnjë veprim tjetër ndaj tyre.

Procedura e parashtrimit të ankesave

34. Çështja e parashtrimit të ankesave rregullohet me nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se aplikuesit kanë të drejtë t'i parashtrojnë ankesë udhëheqësit lidhur me kushtet e pranimi dhe trajtimin nga zyrtarët e Qendrës. Ankesa më pas dërgohet në DShAM, në kuadër të MPB-së, brenda një afati prej 7 ditësh.
35. MKP-ja vërejtë se në dispozicion të aplikuesve. Qendra vendosi një kuti ankesash. Po ashtu, gjatë vizitës, MKP-ja u shpërndau aplikuesve broshura në gjuhët arabe, serbe dhe angleze, të cilat sqarojnë hollësisht mandatin e MKP-së dhe të Avokatit të Popullit, si dhe mënyrën e kontaktimit me MKP-në dhe me IAP-në. Gjithashtu, Ligji për Azil dhe Rregullorja garantojnë qasje të pakufizuar për organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të vendore.
36. Përveç kësaj, ekipi i MKP-së dërgoi edhe kutinë e ankesave të Avokatit të Popullit, e cila do të vendoset në Qendrën e Azilit, ku aplikuesit mund të parashtrojnë ankesat e tyre përmes formës së shkruar.

Ndihma juridike falas

37. Rregullorja përcakton se aplikuesit i ofrohet ndihmë juridike falas.⁵ MKP-ja vërejtë se aplikuesve tash për tash ndihma juridike falas u ofrohet nga organizata joqeveritare Civil Rights Program Kosovo (CRPK) dhe nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

³ Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, nenet 38, 39, 42 dhe 54.

⁴ Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, neni 54.

⁵ Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, neni 37.

Personeli i Qendrës së Azilit

38. Gjatë vizitës, MKP-ja u njoftua nga drejtori i Qendrës se sfida mbetet mungesa e stafit aty, pasi deri më tani janë të plotësuar vetëm katër pozita, ndërsa, sipas Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, parashihet që numri i të punësuarve në Qendër të jetë për 9 persona. Drejtori i Qendrës pohoi se bëri kërkesa të vazhdueshme për plotësimin e stafit sipas Rregullores, mirëpo një gjë e tillë nuk u realizua nga MPB-ja deri më tani.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

39. Avokati i Popullit, nga të gjeturat gjatë vizitës, konstaton se, edhe pse Qendra e Azilit në Magurë ka kushte të mira akomodimi në aspektin e hapësirës, ndriçimit, nivelit të higjienës dhe ngrohjes, megjithatë në tri dhoma, që aktualisht janë jashtë funksionit për shkak të lagështisë dhe rrjedhjes së ujit nga kulmi, nevojiten intervenime të menjëhershme duke përfshirë rinovimin e kulmit për të eliminuar rrjedhjen e ujit dhe gëlqerosjen e dhomave për ta rikthyer funksionalitetin e tyre.

40. Pavarësisht se Qendra e Azilit ofron kushte të pranueshme për familjet dhe fëmijët, vendosja e familjeve në katin e dytë, ku janë shumë pranë katit të parë, në të cilin janë të vendosur meshkujt beqarë, krijon një situatë ku familjarët ndihen të kufizuar në lirinë dhe privatësinë e tyre, duke i detyruar të kalojnë shumicën e kohës në dhomat e tyre.

Andaj Avokati i Popullit konstaton se, duke respektuar interesin më të mirë të fëmijëve dhe nevojat e tyre për liri, siguri dhe zhvillim të shëndetshëm, Qendra ka nevojë për një ambient të veçantë dhe të përshtatshëm për familjet dhe fëmijët, në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes dhe kujdesit për fëmijët në situata azili.

41. Avokati i Popullit, nga të gjeturat gjatë vizitës, konstaton se Qendra nuk ka staf të mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të aplikuesve të akomoduar aty. Andaj konstaton se plotësimi i stafit duhet të bëhet sipas Rregullores (ZKM) NR. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës në Qendrën për Azil në Magurë, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i:

REKOMANDON

Ministrisë së Punëve të Brendshme:

- Të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mënjanimin e dëmtimeve dhe rinovimin e dhomave që aktualisht janë jashtë funksionit.
- Të ndërmarrë veprime duke vendosur familjet në një hapësirë të veçantë dhe të përshtatshme që garanton privatësi, siguri dhe një ambient të favorshëm për zhvillimin e fëmijëve dhe familjes.
- Të punësojë staf në Qendrën e Azilit, sipas kërkesave të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

 Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit